



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 49/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË (HUAMARRËSI), FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
(AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), DHE KFW FRANKFURT AM MAIN
(KFW), PËR PROGRAMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE IV**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV, me një hua në shumën 40 000 000 (dyzet milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 18.7.2019

